INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

ANKETA E KOSTOS SË PUNËS

Viti financiar 2024

Anketa e Kostos së Punës, 2024 (AKP 2024) mat kostot e punëdhënësit për punonjësit e tyre: paga, kontribute, trajnime dhe kosto të tjera. Anketa mbulon ndërmarrjet jo-bujqësore me 10 e më shumë të punësuar me pagë dhe kryhet çdo katër vjet nga INSTAT, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Të punësuarit dhe orët e punës

- Në vitin 2024, ndërmarrjet jo-bujqësore me 10 e më shumë të punësuar kishin mesatarisht 397.328 të punësuar me pagë (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme), ose 396.477 në njësi pune me kohë të plotë[1].
- Të punësuarit me kohë të plotë përbëjnë 99,49 % të të punësuarve, ata me kohë të pjesshme 0,47 % dhe praktikantët 0,04 %.
- Numri më i madh i të punësuarve me pagë është në Industrinë përpunuese, në Tregtinë me shumicë e pakicë dhe në Arsim.
- Një njësi pune me kohë të plotë është paguar mesatarisht për 2.367 orë në vit dhe ka punuar realisht 2.114 orë. [2]

Kostoja e punës dhe struktura e kostos

- Kostoja mesatare vjetore për njësi pune me kohë të plotë është 1.182.734 Lekë (përjashtuar praktikantët).
- Kostoja mesatare mujore për njësi pune me kohë të plotë është 98.561 Lekë.
- Kostoja mesatare për një orë pune është 559 lekë.
- 85,5 % e kostos totale të punës shkon për paga, shpërblime dhe shtesa.
- 14,3 % shkon për kontributet e sigurimeve shoqërore të paguara nga punëdhënësi.
- 0,2 % shkon për trajnimin profesional dhe shpenzime të tjera, si rekrutimi ose veshjet mbrojtëse për punonjësit dhe taksat e punësimit.
- Kostoja mesatare orare rritet me rritjen e madhësisë së ndërmarrjes, me përjashtim të ndërmarrjeve me 500-999 të punësuar, ku është më e ulët se në ndërmarrjet me 250–499 të punësuar.
- Kostoja është më e ulët në ndërmarrjet me 10–49 të punësuar (480 lekë) dhe më e lartë në ndërmarrjet me 1.000 e më shumë të punësuar (685 lekë).

[1] Njësitë e punës me kohë të plotë (FTU) llogariten duke konvertuar të punësuarit me kohë të pjesshme në ekuivalent me kohë të plotë sipas orëve të punës dhe duke i shtuar ata me të punësuarit me kohë të plotë. Praktikantët nuk përfshihen në treguesin FTU


[2] Orët e paguara përfshijnë, përveç orëve të punuara, edhe pushimet vjetore, festat zyrtare dhe lejet e tjera të paguara, ndërsa orët realisht të punuara përfshijnë vetëm orët e kryera në punë.

Për publikim 12/11/2026

Kostoja sipas aktivitetit ekonomik


- Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve kanë koston mesatare orare më të lartë: 1.066 lekë.
- Pas tyre vijnë Informacioni dhe komunikacioni (844 lekë) dhe Industria nxjerrëse (836 lekë).
- Kostoja më e ulët është në Akomodim dhe shërbimin ushqimor (377 lekë), në Industrinë përpunuese (398 lekë) dhe në Furnizimin me ujë, kanalizimet, menaxhimin e mbetjeve dhe rregullimin (414 lekë).

FIG. 1 KOSTO MESATARE ORARE PËR NJËSI PUNE ME KOHË TË PLOTË (NË LEKË)



Burimi i informacionit: Anketa e Kostos së Punës, 2024

FIG. 2 KOSTO MESATARE ORARE PËR NJËSI PUNE ME KOHË TË PLOTË SIPAS AKTIVITETEVE EKONOMIKE (NË LEKË)



Burimi i informacionit: Anketa e Kostos së Punës, 2024

Shënim për përdoruesit:

- *Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT:* Anketa e Kostos së Punës
- *Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf*

Metodologjia

Anketa e Kostos së Punës është një vrojtim statistikor pranë ndërmarrjeve, i cili synon të sigurojë informacion të rregullt dhe të krahasueshëm mbi koston e punës në Shqipëri. Të dhënat e saj përdoren për monitorimin e zhvillimeve në tregun e punës dhe për hartimin e politikave ekonomike e sociale. Treguesit kryesorë mbi koston e punës, llogariten sipas koncepteve dhe kritereve të harmonizuara të ILO-s dhe Eurostat-it. Të dhënat i referohen vitit fiskal 2024. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik.

Kjo anketë kryhet në përputhje me metodologjinë dhe përkufizimet e përcaktuara nga Eurostat, duke siguruar krahasueshmëri të treguesve të tregut të punës me vendet e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare.

Deri më sot, INSTAT e ka zhvilluar Anketën e Kostos së Punës tre herë. Gjatë interpretimit të rezultateve dhe krahasimeve me vitin 2020, duhet të merret në konsideratë ndikimi i pandemisë COVID-19 dhe i masave mbështetëse të ndërmarra nga qeveria. Për trajtimin statistikor të këtyre masave, INSTAT ka zbatuar udhëzimin e Eurostat-it të datës 24 prill 2020, "Guidance Note on Labour Cost Statistics", sipas të cilit subvencionet për pagat regjistrohen si zbritje nga kostoja e punës.

Baza Ligjore

Baza Ligjore mbi të cilën mbështetet vrojtimi katërvjeçar statistikor mbi Statistikat strukturore të Pagave dhe Kostos së Punës përbëhet nga Ligji nr 17, datë 05.04.2018 "Për statistikat zyrtare" dhe Programi Statistikor Kombëtar për periudhën 2022-2026.

Rregulloret

Pyetësori i Anketës së Kostos së Punës, 2024 u përshtat sipas rregullores së Komisionit Evropian "Për statistikat strukturore mbi pagat dhe kostot e punës". Me qëllim që rezultatet e Anketës së Kostos së Punës të jenë të krahasueshme me vendet europiane u zbatuan të njëjtat rregullore që dhe ato zbatojnë:

- Rregulloren e KE Nr 530/1999 mbi "Statistikat strukturore të Kostos së Punës".
- Rregulloret e KE Nr 1737/2005 dhe Nr 1726/1999 mbi "Përkufizimet e përdorura në Statistikat Strukturore të Kostos së Punës dhe transmetimin e tyre në Eurostat.
- Rregulloren e KE Nr 698/2006 mbi "Vlerësimin e cilësisë së statistikave strukturore të Kostos së Punës".

Aktivitetet Ekonomike

Në Anketën e Kostos së Punës u përfshinë të gjitha ndërmarrjet që prodhojnë të mira dhe shërbime, duke përjashtuar aktivitetet e: Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit; Administrimin Publik dhe Mbrojtjen, Sigurimin Social të Detyrueshëm; Aktivitetet të Familjeve si Punëdhënës, Aktivitete të Prodhimit të Mallrave e Shërbimeve të Pandryshueshme të Familjeve për Përdorimin e vet dhe Aktivitete të Organizatave dhe Organizimave Ndërkombëtare. Treguesit sipas aktiviteteve ekonomike janë llogaritur për njësitë ekonomike që bëjnë pjesë në fushën e mbulimit të anketës sipas NVE Rev. 2.0, duke përjashtuar aktivitetet e klasifikuara në seksionin O

"Administrimi Publik dhe Mbrojtja; Sigurimi Social i Detyrueshëm".Rezultatet sipas aktiviteteve ekonomike bazohen në njësitë ekonomike të regjistruara në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve dhe të përfshira në fushën e mbulimit të anketës. Gjatë vitit fiskal që i referohet anketa, u zbatuar klasifikimi NVE Rev. 2.0, i cili ishte në fuqi. periudhës së referencës së anketës, ky klasifikimi ishte në fuqi. Kalimi në versionin më të ri (Rev. 2.1) do të bëhet për herë të parë në anketën e ardhshme të LCS, në 2028, duke siguruar krahasueshmëri me publikimet e mëparshme.

Përkufizime

Kostot e punës i referohen shpenzimeve totale që kryejnë punëdhënësit për stafin e punësuar. Ato përfshijnë kompensimin për të punësuarit, kontributet e sigurimeve shoqërore të paguara nga punëdhënësi, kostot e trajnimit profesional, shpenzime të tjera të lidhura me punësimin, si kostot e rekrutimit dhe shpenzimet për veshje pune, si dhe taksat e punësimit. Subvencionet e marra nga punëdhënësi zbriten nga kostoja totale e punës.

Të punësuarit me pagë janë të gjithë personat që punojnë direkt me ndërmarrjen dhe marrin pagesë nga punëdhënësi.

Të punësuar me pagë me kohë të plotë janë ata persona, orët e zakonshme të punës së të cilëve janë të njëjta me orët rënë dakord kolektivisht ose me orët e zakonshme të punuara në ndërmarrje, edhe nëse kontrata është për më pak se një vit.

Të punësuar me pagë me Kohë të Pjesshme janë personat që përgjithësisht punojnë më pak orë se të punësuarit me pagë me kohë të plotë të të njëjtës ndërmarrje.

Praktikantët janë të punësuarit me pagë që akoma nuk marrin pjesë tërësisht në procesin e prodhimit dhe që punojnë ose nën një kontratë stazhi ose në një situatë në të cilën trajnimi profesional predominon kundrejt produktivitetit.

Numri mesatar i orëve në javë të punuara zakonisht janë orët e punuara zakonisht ose orët e kontraktuara për një të punësuar me pagë të kategorive që vijojnë: një i punësuar me pagë me kohë të plotë, një i punësuar me pagë me kohë të pjesshme, një praktikant.

Pagat për të punësuarit me pagë me kohë të plotë dhe të pjesshme përfshijnë shpërblimet, pagesën për copë dhe punën me turne, shtesat/dietat, honorarët, bakshishet, komisionet dhe pagesat në natyrë.

Pagesat direkte, shpërblimet dhe shtesat përfshijnë vlerat e çdo kontributi social, taksave mbi të ardhurat, etj, të pagueshme nga i punësuari me pagë edhe nëse ato faktikisht mbahen nga punëdhënësi dhe paguhen direkt në skemat e sigurimeve shoqërore, tatim-taksat etj, në emër të të punësuarit me pagë. Pagesat për ditët kur nuk është punuar, përfshihet vetëm pjesa e mbuluar nga punëdhënësi e cila paguhet për lejen e dhënë ligjore të kontraktuar ose vullnetare dhe për festat publike apo ditë të tjera të paguara kur nuk punohet.

Pagesa në natyrë ose përfitimet shtesë janë pagat dhe rrogat të cilat nuk janë transaksione cash/para në dorë. Ata janë mallrat, shërbimet, apo përfitime të tjera të cilat sigurohen falas ose me çmime të reduktuara nga ana e punëdhënësit për të punësuarit me pagë.

Kontributet e punëdhënësit për sigurimet shoqërore (përjashtuar praktikantët) janë kontributet shoqërore të dhëna nga punëdhënësit në mënyrë që të sigurojnë për punonjësit e tyre (me kohë të plotë dhe të pjesshme) të drejtën për përfitime sociale.

Kostot e trajnimit profesional të paguara nga punëdhënësi janë shpenzimet për shërbimet dhe lehtësirat për trajnimet profesionale.

Taksat e punës (Jo taksat mbi të ardhurat) ky variabël mbulon të gjitha taksat në bazë të faturës së pagave dhe rrogave, ose në punësim. Këto taksa janë konsideruar si kosto pune. Gjithashtu mbulon taksat ndëshkimore të paguara nga punëdhënësit për punësimin e shumë pak personave me aftësi të kufizuar, si dhe taksa të tjera të ngjashme.

Subvencionet e marra nga punëdhënësi janë të gjitha shumat e marra në formën e subvencioneve të një natyre të përgjithshme nga ana e punëdhënësit, me qëllim që të kthehen një pjesë ose të gjitha, si kosto e shpërblimit të drejtpërdrejtë të punonjësve, por kjo nuk ka për qëllim për të mbuluar shpenzimet për sigurimet shoqërore ose trajnimet profesionale.

Notë shpjeguese mbi treguesit kryesorë të tregut të punës

Baza e zgjedhjes së ndërmarrjeve për anketën e Kostove të Punës është Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve Ekonomike 2024. Njësitë statistikore të vrojtuara janë ndërmarrjet ekonomike me 10 të punësuar e më shumë për seksionet e NVE Rev. 2.0 nga B deri tek S (pa përfshirë seksionin O).

Zgjedhja e ndërmarrjeve u bë me metodën e zgjedhjes sistematike të rastit ku shtresëzimi u bazua në aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev. 2.0 në nivel dyshifror, dhe në madhësinë e ndërmarrjes. Ndërmarrjet me 50 të punësuar e më shumë janë përfshirë të gjitha në anketë. Madhësia e zgjedhjes për anketën e kostove të punës është 3.326 ndërmarrje jo-bujqësore.

Cilësia e statistikave të tregut të punës

Të dhënat e anketës janë përgjithësuar për të gjithë popullatën në studim (ndërmarrjet jo-bujqësore me 10 e më shumë të punësuar). Procesi i përgjithësimit të të dhënave merr parasysh probabilitetin e zgjedhjes së ndërmarrjeve dhe gjithashtu kompenson për ndërmarrjet të cilat janë:

- pa kontakt;
- të mbyllura;
- të fjetura;
- refuzuan që të marrin pjesë në anketë.

Të dhënat e Anketës së Kostos së Punës u mblodhën në dy mënyra:

- Me anketues të cilët plotësuan pyetësorin e printuar.
- Me dërgimin me e-mail nga ana e ndërmarrjes të pyetësorit të plotësuar.

Nga ndërmarrjet e përzgjedhura, 9,9 % nuk e plotësuan anketën për shkak të mos-përgjigjes, ndërsa 1,3 % rezultuan jashtë fushës së vrojtimit. Të dhënat për rastet e mos-përgjigjes u imputuan nga burime administrative. Duke marrë në konsideratë njësitë që bënin pjesë në popullatën objekt vrojtimi, shkalla neto e pjesëmarrjes rezultoi 92,3 %.

Për çdo tregues në vrojtim është llogaritur varianca. Llogaritja e variancës për koston totale vjetore të punës dhe e koston mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë është bërë në SAS-software, duke përdorur makro CLAN. Në tabelat e mëposhtme do të gjeni devijimet standarde dhe koeficientët e variacionit të dy variablave kryesorë të vrojtimit, kostos vjetore dhe kostos për orë të punës.

TAB. 1 KOEFICIENTËT E VARIACIONIT PËR KOSTON TOTALE VJETORE TË PUNËS SIPAS SEKSIONEVE TË NVE REV.2

Seksioni	Aktiviteti ekonomik	Kosto Totale vjetore e punës (në lekë) $\hat{t}$	Devijimi Standard $\sqrt{V(\hat{t})}$	Koeficienti i variacionit (%) $CV(\hat{t})$
B-S	**Gjithsej**	**468.926.918.690**	**3.530.481.336**	**0,75**
B	Industria nxjerrëse	13.313.750.074	137.047.868	1,03
C	Industria përpunuese	63.070.784.251	364.988.739	0,58
D	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	14.241.718.182	102.350.930	0,72
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave	10.554.057.645	48.281.057	0,46
F	Ndërtimi	40.984.130.450	197.444.193	0,48
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	67.000.837.124	342.992.233	0,51
H	Transporti dhe magazinimi	16.113.542.522	197.670.148	1,23
I	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	14.898.382.254	61.112.450	0,41
J	Informacioni dhe Komunikacion	27.353.458.276	256.904.974	0,94
K	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	27.579.404.138	365.116.572	1,32
L	Pasuritë e patundshme	2.004.104.632	16.862.166	0,84
M	Aktivitete profesionale, Shkencore dhe Teknike	17.771.232.949	165.366.065	0,93
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	32.003.313.154	186.420.230	0,58
P	Arsimi	64.862.459.897	600.587.609	0,93
Q	Shëndetësia	43.337.094.051	304.730.313	0,70
R	Arte, Argëtim dhe Çlodhje	6.348.226.064	49.389.785	0,78
S	Aktivitete të tjera shërbimi	7.490.423.024	46.410.318	0,62

TAB. 2 KOEFICIENTËT E VARIACIONIT PËR KOSTON TOTALE VJETORE TË PUNËS SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES

Madhësia e ndërmarrjes -Size of enterprise	Kosto Totale vjetore e punës (në lekë) Annual labour cost (ALL)	Devijimi Standard Standard deviation	Koeficienti i variacionit (%) Coeficient of variation (%)
Gjithsej	**468.926.918.690**	**3.530.481.336**	**0,75**
10-49	123.881.344.258	1.821.055.761	1,47
50-249	155.918.408.483	1.621.551.448	1,04
250-499	69.447.172.625	381.959.449	0,55
500-999	54.266.905.246	151.947.335	0,28
1000+	65.413.088.076	—	—

Kostoja totale vjetore e punës (për sektorët B-S) vlerësohet 468,9 miliardë lekë, me një devijim standard prej 3,5 miliardë lekë. Për një nivel besueshmërie 95 %, intervali i besueshmërisë për këtë tregues varion nga 462,0 miliardë lekë deri në 475,8 miliardë lekë. Kjo tregon se me 95 % besueshmëri vlera reale e kostos totale është brenda këtij intervali. Koeficienti i variacionit prej 0,75 % tregon një nivel të lartë saktësie të vlerësimit statistikor dhe një variabilitet të ulët të vlerësimit.

Ndërkohë, kostoja totale për ndërmarrjet e madhësisë 50-249 punonjës vlerësohet 155,9 miliardë lekë, me një devijim standard prej 1,6 miliardë lekë. Për një nivel besueshmërie 95 %, intervali i besueshmërisë për këtë tregues varion nga 152,7 miliardë lekë deri në 159,1 miliardë lekë. Kjo tregon se vlera reale e kostos për këtë grup është brenda këtij intervali, duke pasur një koeficient variacioni jashtëzakonisht të ulët prej 1,04 %.